

VENDIM
Nr. 101/2018

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 92/2017,
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE
KLASIFIKIMIT
TË PAGAVE TË PERSONELIT
TË KOLEGJIT TË POSAÇËM
TË APELIMIT”

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. “Lidhja nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, e vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Lidhja nr. 2, “Struktura organizative e Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, e vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2, “Struktura organizative e Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 4.10.2018

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
KRYETARI		(2)
I. KRYETAR	G3*	1
Sekretar	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	1
II. KOLEGJI I GJYQTARËVE		(6)
Gjyqtarë	G3*	6
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(14)
Këshilltarë juristë	80% e G3*	7
Këshilltarë ekonomistë	80% e G3*	7
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-a	1
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		(11)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III- b	3
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-a	1
Përkthyes	II-b	4
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritjeje me popullin	IV-a	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(9)
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	2
Specialist protokoll/arkivi****	IV-a	1
Magazinier	VII	1
Punonjës pastrimi	III	1
Shofer/korrier	VI	1
TOTAL		43

Shënim.

* Paga e gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit përlogaritet me këtë formulë: $G3 + 10\% G3 + \text{shtesën për vjetërsi (e barasvlershme me pagën e kryetarit të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë")}$.

** Kategoria e pagës për sekretarin e kryetarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune, në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

***** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOLEGJIT TE POSACEM TE APELIMIT

